



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.11.2021, ora 14:30

**Drejton mbledhjen:**

**Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Miratimi i programit të punimeve të komisionit (për periudhën 15 nëntor – 24 dhjetor 2021).

Miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit (për periudhën 15 nëntor – 03 dhjetor 2021).

Akt normativ nr. 32, datë 05.11.2021 “Për miratimin e tekstit të disa ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin e furnizimin nga dhe ndërmjet PFIZER EXPORT B.V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.01.2021 të Këshillit të Ministrave”.

#### **Marrin pjesë:**

Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Saimir Hasalla, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Eduard Ndreca, Alqi Bllako, Enkelejd Alibeaj, Saimir Korreshi, Greta Bardeli, Dashnor Sula, Fatmir Mediu, Aurora Mara, Elda Hoti, Gerta Duraku, Toni Gogu, Gledis Çeliku, Bledion Nallbati, , Ermonela Valikaj( Felaj), Dhurata Tyli, Bardhyl Kollcaku, Jurgis Çyrbja, Fatmir Xhafaj, Erisa Xhixho, Gazmend Bardhi.

#### **Mungojnë**

Damian Gjikhuri, Oerd Bylykbashi,

**Të ftuar:**

Eugena Tomini - zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Antoneta Njehrrëna - drejtore e Programit të Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator.

**HAPET MBLEDHJA****Klotilda Bushka – Mirëdita!**

Fillojmë mbledhjen e komisionit me këtë rend dite: miratimi i programit të punimeve të komisionit (për periudhën 15 nëntor – 24 dhjetor 2021); miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit (për periudhën 15 nëntor – 03 dhjetor 2021); akt normativ nr. 32, datë 05.11.2021 “Për miratimin e tekstit të disa ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin e furnizimin nga dhe ndërmjet PFIZER EXPORT B.V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.01.2021 të Këshillit të Ministrave”.

Ne do të jemi komision përgjegjës dhe relator është zoti Toni Gogu.

Me programin e punimeve të komisionit jeni njohur nëpërmjet sekretarisë. A keni ndonjë çështje që doni ta diskutoni? A jeni dakord? A jeni dakord me kalendarin e punimeve? Në rregull.

Në vijim të diskutimit të djeshëm, siç jua kam thënë, programi dhe kalendarin e punimeve janë futur në rendin e ditës, sepse ne e kemi detyrim që sapo të miratohet programi në Kuvend duhet të futen menjëherë edhe në kalendarin e punimeve. Gjithsesi çështjet janë të adresuara, nëse nuk ka kundërshtim, i konsiderojmë të miratuara dhe kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të tretë të rendit të ditës kemi ftuar dhe është prezent nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale zonjën Eugena Tomini, zëvendësministre, dhe zonjën Antoneta Njehrrëna, drejtore e Programit të Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator. Mirë se erdhët! Relator është zoti Gogu.

Zonja Tomini do të na bëjë një prezantim të aktit normativ.

**Eugena Tomini – Përshëndetje!**

Situata epidemiologjike e COVID-it në vend në 15-16 javët e fundit është e qëndrueshme. Sa u përket rasteve pozitive në 24 orë, ka një trend të qëndrueshëm të rasteve që kanë pasur nevojën për hospitalizim dhe ndërkohë ka një trend të qëndrueshëm të rasteve në terapi intensive,

pavarësisht kushteve spitalore në të dyja spitalet COVID 1 dhe COVID 3, të cilat janë kushte semi intensive.

Duhet të theksojmë se kemi një incidencë, e cila është e qëndrueshme sa u përket rasteve. Ndërkohë, po vijon vaksinimi i popullatës me dozën e parë, të dytë dhe të tretë, buster parësore dhe bazale, por ka edhe një zbritje të fashës moshore në fashën +12 për sëmundjet kronike dhe me imunitet deficitar. Aktualisht mbulesa vaksinale është në nivelin 47% me dozë të parë dhe 41% me dozën e dytë.

Ndërkohë, sa u përket dozave të treta, për to kanë shfaqur interes fasha moshore e thyer, ose mosha e tretë, dhe ndërkohë me dozat e treta janë vaksinuar 38 mijë e 378 doza të aplikuara për sa i përket dozës buster dhe dorëz bazale parësore.

Sa i përket frekuentimit në pikat e vaksinimit në qendrat shëndetësore shikohet një trend i rritur sa i përket dozës së tretë, ndërkohë po ecën me ritme të mira aplikimi i dozave të para dhe të dyta.

Dua të theksoj faktin se është duke u bërë një punë sensibilizuese paralele sa u përket prindërve për fëmijët e fashave +12 deri në moshën 18 për faktin e dakordësimit nëse kanë sëmundje bashkëshoqëruese dhe imunitet deficitar.

Në këtë situatë duhet të theksojmë se vijmë sot për marrëveshjen Pfizer, për ndryshimet që i përkasin nenit 2, ku ka qenë e paracaktuar që për çdo donacion ose rishitje duhet të merret një dakordësi për pikën qendrore të Pfizer-it, sepse duhet të ndërhyjmë me akte normative të njëpasnjëshme në aktin normativ fillestar përkundrejt donacioneve që bëjnë shtetet e tjera europiane sa u përket dozave të Pfizer-it. Në këtë kuadër ne parashtrijmë te ju një rregullim të përgjithshëm të këtij neni, me një shtesë në nenin 2, shtesa 2,9. Një nën nen shtesë i pikës 2 do të mundësojë që ne të mos bëjmë akte normative të njëpasnjëshme për donacionet, por me anë të kësaj rregulloreje të përgjithshme do të kemi një lehtësim për marrjen e donacioneve.

**Klotilda Bushka** –Faleminderit!

Zoti Gogu.

**Toni Gogu**- Faleminderit!

Ashtu siç u paraqit edhe nga zëvendësministrja, akti që ne kemi sot nga ana e kushtetutshmërisë është në përputhje me Kushtetutën, pasi ekzistojnë të dyja parakushtet që kanë të bëjnë me nevojën dhe urgjencën. Pra, nevoja është imediate, por edhe urgjenca është e tillë. Shohim se mbulesa është 47% dhe 41%. Kështu që janë përmbushur të dyja parakushtet.

Nga ana tjetër, ndryshimi që konsiston është ai që zëvendësministrja e parashtrori, pra lehtësohet procedura. Në marrëveshjen bazë, që qeveria ka nënshkruar në janar të këtij viti, parashikohet që për çdo dozë Pfizer, qoftë e dhuruar, ose e blerë nga palët e treta, qeveria shqiptare duhet të marrë miratim paraprak me shkrim nga kompania Pfizer. Kjo do të kërkonte ndërhyrje të herëpashershme në marrëveshje bazë dhe do të bënte akte normative të shumta. Në rastin konkret, ky miratim paraprak me shkrim zëvendësohet me njoftim të kompanisë Pfizer, pasi ne jemi të detyruar ta marrim drejtpërdrejtë nga kjo kompani. Kështu që, lehtësohet procedura e marrjes së vaksinave.

Duke plotësuar elementet e kushtetutshmërisë, por duke qenë edhe brenda ekonomisë ligjore, pasi shmangen një sërë ndërhyrjesh të tjera në marrëveshjen bazë unë ju ftoj që këtë akt normativ ta miratojmë pa humbur kohë!

Në këtë moment gjej rastin të ftoj bashkëqytetarët që të vaksinohen, pasi vaksinimi është e vetmja mënyrë që ne mund të shmangim karantinimet e mëtejshme, pasi po shikojmë se ka një valë të katër të goditjes nga COVID-i.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Po, zoti Alibeaj.

**Enkelejd Alibeaj** - Faleminderit!

Edhe unë i bashkohem thirrjes që bëri relatori për vaksinimin ndaj COVID-it. Po, shqiptarët duhet të vaksinohen pa asnjë lloj skepticizmi dhe rënie në kurthe psikologjike konspirative. Pra, duhet të vaksinohen. Nuk bëhet shaka me jetën.

Ju parashtruat se ndryshimi që vjen është një lehtësim procedurash. Në rastet kur kemi donacione, nuk është e nevojshme të kërkohet leje herë pas here, pra sa herë ka donacione, ose mjafton ky ndryshim dhe ju e keni tashmë më të lehtë për donacionet. Aktualisht, sa është gjendja e stokut të vaksinave?

Ju thatë se deri tani me një dozë janë vaksinuar 47% dhe me dy doza 41% e popullsisë, me dozën e tretë dhatë një shifër 38 mijë. E mira do të ishte që këtë shifër ta kthenit në përqindje, sepse edhe thirrjet tona do të ishin më të forta. Është bërë e udhës që të miratohen me akte normative, kjo është çështje kushtetuese. Pse besoni se jeni në kushtet e emergjencës dhe të urgjencës, që janë dy nga kriteret kushtetuese për të miratuar një akt normativ, jo në rrugën normale të ligjeve, por të akteve normative? Kjo është një gjë që duhet sqaruar.

Nëse shteti shqiptar ka sasi stoku të mira për vaksinimin, nuk do të ishim në kushtet e nevojës dhe të emergjencës. Dua të përgenjshtrhem këtu, por pres një përgjigje nga ana juaj.

Së treti, ju keni ardhur me këtë akt normativ, me idenë për të hequr kërkesat e njëpasnjëshme në rastet e donacioneve. Kjo do të thotë se paska kanale dhe mundësi për të marrë sasi vaksinash nëpërmjet donacioneve, pra për të mos i blerë. A mund të na bëni ju një parashikim sa është ose sa do të jetë raporti midis sasive të blera dhe sasive të pritshme që do të na dhurohen? Sepse kjo është një gjë e mirë. Kur të na dhurohen minimalisht ulet edhe shpenzimi i parasë publike që përdoret për blerjen e këtyre vaksinave.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Zoti Mediu.

**Fatmir Mediu** - Duke u bashkuar me thirrjen e kolegëve, unë do të bëja edhe disa pyetje. Tashmë është bërë praktikë e njohur kjo marrëdhënie me Pfizer-in. Po me kompanitë e tjera a ka ndonjë marrëdhënie, që të na çojë në të njëjtën praktikë si me Pfizer-in për të mbuluar nevojat?

Pyetja e dytë ka të bëjë me një diskutim që kemi bërë më parë këtu për grupet vulnerabël dhe me probleme shëndetësore. Deri në çfarë mase është arritur vaksinimi i këtyre grupeve, duke pasur parasysh edhe një evidencë tuajën për atë moshë që ka probleme të theksuara shëndetësore dhe e kanë të nevojshme vaksinën e tretë?

Së treti, kur mendoni se do të fillojë aplikimi i dozës së tretë për popullsinë në tërësi, ndërkohë që në Europë ose në SHBA ky proces ka filluar dhe po ecën?

Së katërti, vaksinimi i fëmijëve, siç thatë ju, është ulur moshë e vaksinimit, por duke pasur parasysh edhe faktin që fëmijët janë përcjellës së COVID-it si është niveli i vaksinimi të tyre?

Së pesti, në SHBA-të, përveç vaksinave, tashmë industria farmaceutike ka filluar prodhimin e një serie pilulash kundër COVID-it dhe SHBA-të kanë blerë 10 milionë të parat. A kemi ndonjë gjasë ose qasje për të përfituar edhe ne nga këto zhvillime pozitive në vend, që të zëvendësohet vaksina me këto ilaçe të reja?

**Klotilda Bushka** – Zonja Tomini.

**Eugena Tomini** - Faleminderit për pyetjet!

Sasitë e vaksinave të ardhura në Shqipëri janë 2 milionë 663 mijë e 100 vaksina në total. Deri në këto momente janë aplikuar 2 milionë e 25 mijë e 961 vaksina. Pra, është një stok rreth 647 mijë doza. Ndërkohë, dua të theksoj se janë vaksina të Pfizer-it në bazë të kontratës, të donacioneve AstraZeneca, Sputnik, coronavak.

Sa i përket përqindjes së dozës së tretë të aplikuar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Klotilda Bushka** – Mbaroni me përgjigjen për pyetjet e zotit Mediu dhe bëni pastaj me pyetjet e tjera.

**Eugena Tomini** – Sa i përket dozës së tretë të aplikuar, ne thamë se kemi filluar aplikimin e 60+ për dozë të tretë, dozë të parë bazale për persona që janë 60+ me imunitet të kompromentuar dhe komprimuar, quhet parësore, bazale buster për ata që kanë shfaqur imunitet, por kanë nevojën për shkak të kalimit të 6 muajve nga momenti i bërjes së dozës së dytë dhe janë 38 mijë e 376 persona në përqindje 1,7% e totalit të aplikimeve.

Sa i përket aktit normativ dhe kushteve të emergjencës, OBSH-ja nga marsi i vitit 2020 ka deklaruar situatë emergjence në vend në mbarë botën. Ndërkohë, aktualisht përvijon situata e emergjencës. Akti normativ ka sjellë një lehtësi për situatës së emergjencës dhe nevojës për të arritur një mbulesë vaksinale. Sipas kriterëve të OBSH-së deri në vitin 2021 fundi i tillë kemi 40%, deri në pranverën e vitit 2022 duhet të kemi 70% të popullatës të mbuluar, që është 2,2 milionë banorë.

Sa i përket pyetjes së tretë të zotit Alibeaj, për raportin e sasive të ardhura, sasive të parashikuara dhe sasive të pritshme në bazë të donacioneve, sigurisht që ne si Ministri e Shëndetësisë kemi theksuar se deri në fund të vitit do të arrijmë të sigurojmë, në bazë të kontratave aktuale, 3 milionë vaksina dhe deri në mesin e vitit 2022 në 5,5 milionë vaksina.

Sigurisht, parashikimet sa u përket donacioneve janë të vështira, më tepër për të thënë faktin se vendet e BE-së kanë qenë të predispozuar dhe donacioni i BE-së që në pritje kemi edhe 104 mijë doza të tjera në kuadër të asaj që dha BE-ja për rajonin e Ballkani. Ndërkohë, këto donacione janë të mirëpritura. Parashikimi për donacionet është abstrakt.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Klotilda Bushka** – Zonja Tomini, nëse nuk i keni mund të na i sillni më vonë.

**Eugena Tomini** - Po, do t'jua vë në dispozicion.

Sa i përket pyetjes së zotit Mediu për praktika të tjera, unë dua t'ju them se ne jemi me instrumentin e COVAX-it. Kontrata kryesore ka qenë e Pfizer, ndërkohë instrumenti COVAX, si mekanizëm i OBSH-së, ka mundësuar lëvrimin e vaksinave të tjera, përveç donacioneve ose kontratave që janë bërë drejtpërdrejtë me distributorët.

Sa i përket pyetjes së dytë për grupet e riskut dhe fillimin e dozës së tretë parësore, bazale ose buster, ne prej 1 nëntorit i gjithë sistemi është në gatishmëri për pritjen e popullatës nga mosha 60+ me sëmundje kronike, duke bërë zbritjen siç filluam me grupet e riskut nga grupet 90+ e duke zbritur. Ndërkohë, ka filluar aplikimi i vaksinës së tretë buster dhe parësore bazale për 18- 59 vjeç.

Kjo do të thotë se të gjithë ata që vuajnë me sëmundje kronike ose imunitet të kompromentuar mund të paraqiten për të aplikuar dozën e tretë buster parësore dhe bazale pasi kanë kaluar 6 muaj nga doza e dytë e aplikuar.

Sa i përket pyetjes për fillimin e vaksinimit, doza e tretë ka filluar dhe grupet e riskut janë prioritarë për t'u aplikuar doza e tretë për të shtuar nivelin e antikorpeve dhe për të rritur imunitetin në këto grupe risku.

Sa i përket vaksinimit të fëmijëve, është me vend adresimi i çështjes nga ana juaj. Sërish po me datën 1 nëntor ka filluar thirrja ose ftesa për fashën 12-15 me imunitet deficitar, me sëmundje kronike. Me rekomandim të mjekut të familjes, me rekomandim të mjekut pediatër dhe me dakordësinë prindërore ka filluar një aplikim, por paralelisht ka filluar edhe në strukturat arsimore sensibilizimi për gjithë këtë fashë, për të dhënë informacionin e duhur, qoftë nga strukturat arsimore, komiteti i prindërve, si dhe për të ndikuar kundrejt një pozitiviteti në aplikimin e vaksinës në këtë fashë apo në këtë grupmoshë, ku ka probleme bashkëshoqëruese. Njëkohësisht fasha 16-18 vjeç, është sërish e ftuar masivisht për të aplikuar dozën e parë të vaksinave anti-Covid.

Theksojmë se vakcina e aplikuar nga mosha 12-18 vjeç, meqenëse është vakcina e vetme e miratuar dhe e certifikuar ndaj Covid-19, do të jetë vakcina Pfizer.

Për sa u përket inovacioneve në drejtim të terapisë, si çdo shtet tjetër, edhe Shqipëria përkrah inovacionin deri në momentin e certifikimit, pavarësisht se FDA-ja e ka bërë miratimin e një sasive të tillë të konsiderueshme mbi buxhetin e pilulës anti-Covid. Edhe Shqipëria ka paraqitur kërkesat e saj përkundrejt medikamentit antiviral, por sigurisht deri në konfirmimin, në mbarimin plotësisht të të gjitha studimeve shkencore në drejtim të efekteve pozitive dhe në vendosjen në protokoll ose në udhëzuesit aktualë, të cilët janë të rifreskuar në vazhdim, do të jetë pjesë e nxitjes së marrjes së pilulës ose të ftesës për marrjes së pilulës antivirale, aktualisht të miratuar nga FDA-ja.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Shumë faleminderit për të gjitha këto sqarime, zonja Tomini!

Në fakt, më lejoni t'ju falënderoj si ministri, për gjithë punën që jeni duke bërë, si dhe gjithë mjekët, infermierët e vaksinatorët në çdo pikë ku u shërbejnë qytetarëve, duke iu bashkuar edhe unë thirrjes së kolegëve, që të gjithë qytetarët t'u drejtohen qendrave të vaksinimit dhe të tregojnë kujdes e të mos e neglizhojnë këtë çështje.

Për çështjen e vaksinës së fëmijëve, është e njëjta dozë edhe për moshën 12 e sipër?

**Eugena Tomini** – Po, zonja kryetare, është e njëjta dozë, aplikimi është me të dyja dozat, 0, 5 mililitra.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, zoti Gogu ka një pyetje.

**Toni Gogu** – E nderuara zonja zëvendësministre,

Ju na informuat se në qershor të vitit 2022, Republika e Shqipërisë synon të sigurojë një mbulim vaksinal prej 5, 5 milionë dozash. E kam kuptuar mirë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo të aplikuara. Pra, t'i kemi të siguruara, stok.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pikërisht. Pyetja ime fillon tani: a është e parashikuar në buxhetin e vitit 2022 e tërë sasia që na çon nga 2, 6 milionëshi në 5, 5 milionë?

Kjo është pyetja.

**Klotilda Bushka** – Po, zonja Tomini!

**Eugena Tomini** – Dozat janë të parashikuara në buxhetin e vitit 2022.

**Klotilda Bushka** – Zonja Çupi ka kërkuar fjalën.

**Dhurata Çupi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Tomini!

Në fakt, kjo imja nuk është edhe aq pyetje, sa diskutim ose koment. Ne jemi të paktën tre deputetë, që përfaqësojmë qarkun Dibër, qark që në fakt ka pasur shumë fatalitete në rastin e Covid-19, ka pasur humbje jete, ashtu si dhe në qarqe të tjera, por unë përfaqësoj Dibërën ndaj po flas për të.

Lidhur me këtë, gjatë prezantimit të aktit normativ, që miratuam para dy javësh, më duket, ministrja deklaroj se Dibra është e vaksinuar në një raport prej 35 % të popullsisë. E them këtë për shkak se ne deputetët, unë, por besoj se edhe dy kolegët e mi, duam të kemi informacion në mënyrë



të vazhdueshme, se sa është raporti, sa është përqindja e qytetarëve që përfaqësojmë e që na kanë votuar. Shfrytëzoj këtë rast për t'u bërë thirrje të gjithë qytetarëve që nuk i kanë marrë dozat e vaksinës deri më sot, të kenë besim dhe ta marrin vaksinën për shëndetin e tyre.

Diskutimi është, edhe në vazhdim të saj çfarë tha zoti Alibeaj, se ju deklaroni që akti normativ sillet një herë dhe ne duhet të miratojmë që, nëse ka donacione apo blerje, akti normativ të mos vijë më të miratohet nga ne, por me miratimin e sotëm, ju si ekzekutiv veproni me këtë akt normativ. Ajo çfarë unë kërkoj është: e para, do të ketë një raport. Pra, nëse ka donacione, i bie që të ulet masa e buxhetit që është miratuar për blerje, dhe ndryshimet në buxhet do të vijnë të miratohen nëpër komisione. Duke shfrytëzuar këtë rast, them se edhe ne marrim informacion për qarkun tonë, se sa është vaksinuar, sa nuk është vaksinuar, sa janë donuar dhe sa janë blerë.

Pra, unë nuk mendoj që ne thjesht të votojmë sot aktin normativ dhe të mos vijë më këtu asnjë informacion në lidhje me sa është blerë e sa është donuar. Unë kështu e kuptova: që ne sot miratojmë ndryshimet e aktit normativ, dhe gjithashtu, me këto ndryshime ju autorizojmë që ky akt normativ të mos vijë më për miratim në parlament.

Në këtë aspekt unë reagoj dhe do të doja që çdo ndryshimi aktit normativ të vijë në komisione. Kështu, edhe ne si deputetë, vihemi në dijeni se cili shtet ka donuar, që të dimë se cilit shtet t'i themi faleminderit, sa është masa e donuar, sa është masa e blerë dhe ndryshimet në buxhetin konkret.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Zonja Tomini, keni një përgjigje?

**Eugena Tomini** – Absolutisht që nuk është ky qëllimi i marrëveshjes ose i aktit normativ të sotëm, por është vetëm përkundrejt marrëveshjes Pfizer. Çdo informacion i detajuar përkundrejt donacioneve e blerjeve, do të jetë në dispozicionin tuaj, sa herë që të kërkohet dhe që do të jetë mundësia për thirrje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, absolutisht po. Nuk është ky qëllimi i sotëm. Ne nuk ndryshojmë asnjë rregullore përkundrejt aktit normativ.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Atëherë, për një sqarim, zoti Gogu ka kërkuar fjalën si relator.

**Toni Gogu** – E nderuara zonja Tyli,

Në lidhje me çfarë ne po miratojmë sot, ndryshimi ka të bëjë vetëm me kompaninë Pfizer. Ngaqë ju e përsëritët shumë shpejt dhe i mëshuat pjesës së donacionit, ka të bëjë edhe me donacionin, ka të bëjë edhe me blerje nga vende të treta. Pse?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ja, ta sqaroj.

Pra, Komisioni Europian, në marrëveshjen që ka lidhur vetë me Pfizer-in, i ka lejuar vendet anëtare që edhe të dhurojnë, por edhe të shesin, nëse duan. Prandaj është e vështirë që ministria jonë të parashikojë se kush do të vendosë të dhurojë dhe kush do të vendosë të shesë. Ajo çfarë ne po bëjmë sot, është që po lehtësojmë gjithë procedurën, që të mos shkojmë t’i marrim miratim paraprak me shkrim Pfizer-it, nëse do ta marrim këtë sasinë që po na e dhuron apo po na shet filan vend, por thjesht ta njoftojmë dhe t’i themi: e nderuara kompani Pfizer, për dërgesën tuaj apo në prodhimin që ju bëni për Shqipërinë, kaq do t’i blejmë nga filan shtet ose do të na i dhurojë filan shtet, kështu që na i llogarisni atje. Pra, nuk vijmë të harxhojmë ditë e kohë për të miratuar ndryshime në marrëveshjen bazë, por thjesht i njoftojmë paraprakisht. Kjo do të thotë se informacioni mbi sasinë e vaksinave, mbi shpenzimet që vendi ynë bën përkundrejt Pfizer-it, është një informacion tërësisht i disponueshëm nga Kuvendi i Shqipërisë, nga qeveria, nga të gjitha palët. Madje, në këtë marrëveshje që po miratojmë sot, parashikohet gjithashtu edhe detyrimi i të gjitha institucioneve shtetërore për të ruajtur sekretin tregtar, që kompania Pfizer ua ka kërkuar të gjitha vendeve, duke filluar nga Komisioni Europian dhe të gjitha vendet e tjera, me të cilat ka marrëveshje.

**Klotilda Bushka** – Po, zoti Mediu.

**Fatmir Mediu** – Unë dua ta ngre edhe një herë këtë shqetësim në raport me ata që vuajnë nga sëmundjet kronike, por në mënyrë të veçantë ata me imunitete të komprometuara. Në dijeninë time, në një pjesë të madhe të vendeve të Bashkimit Europian, jo vetëm pacientët që janë me sistem imunitar të kompromentuar, por dhe mjekët, kanë arritur të jenë në vaksinim të plotë me dozën e tretë, për shkak të marrëdhënieve dhe kontakteve që kanë me këta pacientë.

Këtu dua të bëjmë një diferencë. Nëse kemi pasur një praktikë duke konsideruar moshën, është shumë e rëndësishme të shikojmë riskun që kanë këta pacientë, çështje që edhe për arsye edhe personale, e kam ndjekur nga afër. Do të ishte mirë të bëhej një identifikim i qartë i gjithë këtyre pacientëve, për të cilët besoj se duhet të ketë një data baze nga ministria, që kanë sistem imunitar të kompromentuar, dhe të ketë një angazhim shumë më i madh e proaktiv të Ministrisë

së Shëndetësisë, për t'i identifikuar e për t'u kërkuar të bëjnë vaksinën e tretë. Këtu nuk flitet thjesht për moshë, po për një risk të shtuar të këtyre pacientëve.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Mediu!

Përpara se t'ju jap fjalën, zonja Tomini, dua të them për të gjithë kolegët, që në aktin e sotëm, që i referohet vetëm marrëdhënies me Pfizer-in, ne kemi të dhëna për raportin me Pfizer-in, ndërkohë që gama e vaksinave që vijnë në Shqipëri, është shumë më e gjerë se kaq. Informacion në lidhje me këtë ka në faqen e Ministrisë së Shëndetësisë, ndarë sipas kompanive që i sjellin, por edhe sipas dërgesave nëpër qarqe. Është një faqe e dedikuar për mbrojtjen nga coronavirusi që është për Shqipërinë, ku ka informacione në lidhje me këto çështje.

Gjithashtu, duke qenë se një nga mënyrat përmes të cilave ne marrim informacion në lidhje me procesin e ardhjes së vaksinave dhe mbulimit të popullsisë me vaksina, nuk është vetëm nëpërmjet këtij komisioni, sepse ne këtu mund të marrim informacion në lidhje me Pfizer-in, në bazë të aktit normativ, por ka edhe akte të tjera, të cilat nuk vijnë në Kuvend, ngaqë janë raporte direkte të ministrisë apo të qeverisë. Nëse të gjithë ne sot të donim të kishim më shumë informacion, këto janë dy burimet e informacionit, që unë do t'ju këshilloja të ndiqni, por mund të bëhet edhe direkt me shkresë, për informacione të caktuara, në ministrinë e Shëndetësisë.

Zonja Tomini, fjala për ju!

**Eugena Tomini** – Për zotin Mediu vetëm një saktësim.

Pyetja juaj adresohet për grupet e riskut. Ndërkohë, protokollin dhe udhëzimin përkundrejt aplikimit të dozës së tretë, që është buster, dhe aplikimi i dozës së tretë parësore bazale, fillimisht është për tre grupe dhe ka filluar që me 1 nëntor. Është për personelin shëndetësor, meqenëse është vija e parë e riskut, është për të gjithë punonjësit dhe azilantët në shtëpitë e kujdesit për azilet, por është edhe për fashën 60 plus. Ndërkohë, paralelisht ka filluar edhe për 18-59, për fashën me grupe risku, që janë me sëmundje bashkëshoqëruese dhe imunitet të kompromentuar. Kjo nuk do të thotë se pas kalimit të kësaj faze në fazën e mëvonshme, sipas periudhave të aplikimit të vaksinës nga doza e dytë në 6 muaj, të vijojë aplikimi i dozës së tretë për të gjitha grupet e tjera, pavarësisht nivelit të riskut.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zonja Tomini!

Ka ndonjë diskutim tjetër, që më pas të kalojmë në votim?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, zonja Felaj.

**Ermonela Felaj** – Diçka shumë të vogël. Në fakt, marr shkas nga ajo që po thoshte Dhurata. Unë besoj se publikut dhe të gjithëve ne, do të na interesonte të kishte – dhe nuk e di nëse këtë mund të na e konfirmoni ju nëse ekziston apo jo – një informacion në faqen e Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me sasinë në total të vaksinave të aplikuara deri më tani, në raport me fashat moshore, në të cilat e kemi zbatuar, për të kuptuar se sa është numri i njerëzve të pavaksinuar, duke shtuar këtu edhe kategorinë 12 plus. Mendoj se kjo e dhënë mund t'i paraprijë edhe ndonjë debati të mundshëm apo një diskutimi të mundshëm publik, në momentin kur është folur shumë se Komiteti Teknik, një nga masat e tjera që kërkon të marrë, por ne po e shohim në fakt, se Europa është duke e marrë dhe është duke e ngritur si një alert, qoftë karantinën e personave të pavaksinuar, qoftë dhe faktin se nuk lejohen në ambiente të mbyllura, që mund të jenë lokale, restorante, kinema e çfarë dolloj ambienti tjetër, që njerëzit e pavaksinuar të mund të hyjnë atje. Jo më larg se dje po dëgjoja Kryeministrin grek, që nuk do të vlente testi, tamponi si provë që ke kryer vaksinimin, por vetëm certifikata e vaksinimit. Nëse ju e bëni këtë të dhënë, këtë lloj informacioni jo çdo ditë, por në një periudhë të caktuar, do të ishte shumë gjë e mirë. Mendoj se do të ishte mirë të bëhej, duke u ndarë me qarqe ose me bashki, me qëllim që të kuptohej se ku kemi më shumë problematikë, dhe natyrisht se ku duhet të zërë më shumë vend edhe apeli ynë për të çuar përpara vaksinimin.

**Eugena Tomini** – Me shumë vlerë, zonja Felaj. Pavarësisht se ne paraqesim çdo ditë numrin e vaksinave në total, ndërkohë që deklarohet edhe sa herë ka prurje të vaksinave në nivel kombëtar, absolutisht që është me vend edhe paraqitja sipas fashave mbulesa vaksinale edhe në nivele qarku. Absolutisht që është më se me vend sugjerimi juaj.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Për diskutim, zoti Alibeaj?

**Enkelejd Alibeaj** – Faleminderit, zonja kryetare!

Bashkohem edhe unë me sugjerimin e zonjës Felaj. Pse? Për një arsye fare të thjeshtë: nëse ka në publik opinione, teori konspirative, quajini si të doni, këto vijnë për shkak të jotransparencës. Është shumë e domosdoshme të bëhet transparente, se sa është pjesa e popullsisë është vaksinuar, cilat fasha moshore, në cilat zona, qarqe, në mënyrë të detajuar nëse është e mundur. Pse? Sepse unë shoh, të paktën nga përgjigjet që ju dhatë, se 47 % janë me një dozë vaksine, 41 % janë me dy vaksina, dhe vetëm 1, 7 % me 3 vaksina.

Nuk dua të bëj vlerësim nëse është shumë apo pak, por ama shoh një të dhënë tjetër: që kemi ende 640 mijë stok. Pyetja është: pse popullsia shqiptare nuk po kërkon me ngulm, që të vaksinohet një orë e më parë? Nuk po them se çfarë mund të mendojnë në mendjet e tyre shqiptarët, por se cili është detyrimi i qeverisë, e jo vetëm i qeverisë, por edhe i Kuvendit e i të gjitha institucioneve, e para për t'i ndërgjegjësuar, dhe për të hequr e për të davaritur çfarëdo lloj reje konspirative në mendjet e tyre. Ky është shërbimi që do të duhet të bëjmë. Minimumi është transparenca.

Së dyti, lidhur me çështjet që ngrita për miratimin me akt normativ. Në fakt, kjo nuk ishte çështje e aspektit shëndetësor, por e aspektit kushtetues, sepse parlamenti do të duhet të merakoset edhe për standardet kushtetuese të miratimit të ligjeve, pra edhe të akteve normative, e nëpërmjet kësaj, edhe kontrollit që i bën qeverisë.

Ju thatë se nuk mund ta parashikoni se sa do të jenë të pritshme donacionet. Shpresojmë të jenë shumë, me idenë për të kursyer paratë e shqiptarëve. Por këtu mund t'ju them gjënë tjetër, e ndoshta kjo nuk ka lidhje me ju, sa me kolegen tuaj në krah, Antonetën, që i kupton mirë standardet kushtetuese, nevojat dhe urgjencat kur nuk ke s'ke mundësi tjetër alternative, nuk pret dot që të miratohet ligji me procedurat e veta, sepse do të duhet të bëhet menjëherë.

Ndërkohë, kemi 640 mijë stok, të cilat nuk harxhohen dot as për dy javë, as për katër javë, as për tre muaj, me sa shoh në raportin e numrit të të vaksinuarve dhe të aktit normativ, që është miratuar që në janar të këtij viti. Domethënë, nga janari deri më sot, janë 2 milionë e 25 mijë. Nga e tëra, pra, janë tri të katërtat të harxhuara, po e bëj fare të thjeshtë, ndërsa një e katërta është ende e paharxhuar. Pra, kjo është një kohë, besoj unë, që deri në tre muaj e mbulon. Mirë do të ishte ta mbulonte më shpejt, në fakt. Dua të dal në konkluzionin, e këtë e kam edhe për kolegët e Kuvendit, se nuk do të duhet abuzuar edhe me instrumentin e akteve normative, sepse, siç e dimë fare mirë të gjithë, është një raport i përmbysur midis të drejtës së qeverisë dhe të drejtës së Kuvendit. Me aktet normative miratohen rregulla. Ne e dimë fare mirë se ato vërtet miratohen në parlament, por ama procesi legjislativ pothuajse eliminohet, dhe është gjë shumë e rëndësishme, të cilën ky Kuvend duhet ta ruajë, duhet ta prezervojë. Ja pse është i drejtë edhe meraku i zonjës Çupi. Nëse do të ishte një procedurë ligjore normale, në Komisionin e Ligjeve, përballë do të duhej të ishit ju, por do të duhej të ishte edhe ministrja. Kontrolli, funksioni i kontrollit të Kuvendit ndaj qeverisë realizohet edhe gjatë procesit të miratimit të ligjeve.

Kësisoj, për këtë arsye, ju bëj të qartë se nga ky moment, vota ime do të jetë pro; pra jo thjesht e vetëm me thirrje të vaksinimit po e po, por edhe vota do të jetë pro, sepse tekefundit, unë shpresoj e madje uroj që qeveria të jetë sa më e suksesshme, që të sigurojë sa më shumë sasi vaksinash si donacion, si dhuratë, pra të mos i blejë, në kuptimin që të mos harxhojë parane publike. Këtu do të isha realisht pro. Vota jonë është pro në këtë pikë.

Megjithatë, shoh gjënë tjetër: që ka stok ende, ka një nxitim të pakuptueshëm për ta miratuar me akt normativ. Kjo më duket më tepër sikur është një lëvizje propagandistike, se sa realiste. Në dukje, në fasadë. Uroj të mos jetë e tillë.

Këto kisha unë si sqarime në lidhje me këtë procedurë të miratimit.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Po, zoti Qefalia.

**Xhemal Qefalia** – Zonja kryetare,

Unë do të ndaja një mendimin, që e shprehën me të drejtë edhe kolegët. Ne jemi dakord për gjithë punën e mirë që po bëhet nga Ministria e Shëndetësisë, nga infermierët, nga mjekët, për të pasur një vaksinim sa më optimal. Por unë nuk jam dakord me atë çka zoti Alibeaj tha, që e konsideron këtë stokun si vakcina të mbetura. A do të ishte më mirë që këto vakcina...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po shpreh mendimin tim tani. A do të ishte më mirë që këto vakcina të ishin në dispozicion të Ministrisë së Shëndetësisë për kategori të ndryshme, edhe për vaksinën e tretë, apo të mos kishim fare në gjendje?

Unë mendoj që Ministria e Shëndetësisë është përpara me këtë punë, sepse po siguron vakcina të tjera, ka vakcina sërish në dispozicion të këtyre kategorive, pavarësisht thirrjeve të disa skeptikëve nëpër televizione apo portale që hezitojnë dhe për këtë fakt dua të përgëzoj edhe deputetët e opozitës që në këtë pikë jemi të gjithë pikë, duke i ftuar qytetarët shqiptarë për ta vazhduar vaksinimin.

Pra, kjo nuk duhet të konsiderohet sikur këto vakcina kanë mbetur, sepse edhe sot e kësaj në zonat tona nga ana e institucioneve përkatëse, por edhe nga lëvizja që po bëhet në mënyrë dinamike për të shkuar edhe pranë qytetarëve që e kanë të pamundur për t'u paraqitur pranë këtyre qendrave të vaksinimit është diçka që duhet përshëndetur, pasi angazhimi total i të gjithë stafit mjekësor dhe i drejtuesve të Ministrisë së Shëndetësisë është i ndjeshëm nga ana e të gjithë qytetarëve shqiptarë.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Fjalën e ka zoti Sula.

Më pas fjalën e ka zoti Gogu si relator.

**Dashnor Sula** – Faleminderit, zonja kryetare!

Do të dëshiroja që në fillim të fjalës sime të kem mirëkuptimin e deputetëve të maxhorancës për dy probleme që dua të ngre, të cilat nuk kanë të bëjnë fare me çështje politike, sepse siç jua thashë në këtë drejtim jemi të gjithë bashkë.

Duke marrë shkas nga disa informacione të sigurta, aq më tepër edhe nga emisionet investigative të Stop-it dhe të Fiks Fare për rastet e përhapura që kemi, aq më tepër që edhe Prokuroria dhe Policia e Shtetit i kanë vënë përpara përgjegjësisë personat që kanë abuzuar sa u takon testeve të PCR-së, por duke pasur parasysh edhe skepticizmin që është një fashë e caktuar, sidomos sa i takon rinisë, që është evidente, e shoh si një shqetësim shumë të madh mënyrën se si veprohet. Të jeni të sigurt, siç jua thashë të mos më paragjykoni, që ka abuzim sa i përket bërjes së vaksinave sa u takon personave që e kanë si detyrë ta bëjnë në mënyrë reale vaksinën. E them këtë, sepse mund...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Është shumë e vështirë dhe e pamundur...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Regjistrimi po e po, por a kemi mundësi si ta bëjmë të mundur bllokimin në mënyrë që të mos kemi abuzime, pra me anë të një kontrolli sa më të fortë, ndoshta edhe monitorimi gati me dublim apo me mjete elektronike apo diçka e tillë, sepse kam bindjen se deri te të afërmit e mi, madje edhe persona që i njohim, kanë një skepticizëm mjaft të madh për të mos e bërë vaksinën, duke gjetur rrugën e shkurtër për ta shmangur. Kjo më pas do të bëhet një burim infeksioni, sepse nëse e dini e gjithë rinia rri nëpër lokalet e natës kështu që imagjinoni se çfarë problematikash mund të sjellë kjo gjë.

Këta fëmijë quhen të vaksinuar, nëse e kanë në programin *e-Albania* e më pas fillojnë problematikat e tjera.

Unë e kam shqetësim real, sepse mjafton një informacion nga 5 persona që e kanë këtë tendencë, atëherë shifrat do të jenë në rritje përditë, duke ndikuar edhe te personat e tjerë.

Është bërë goxha propagandë e mirë, por nuk duhet të harrojmë që e keqja depërton më shpejt sesa e mira dhe tashmë me qarkullimin nëpër rrjetet sociale e keqja është në ekstrem, madje edhe te ne vijnë informacione të tilla.

**Klotilda Bushka** – Apeli i bërë nga zoti Sula vlen dhe është për të gjithë. Patjetër që kontrolli duhet të ekzistojë për të evituar pikërisht këto pasoja dhe të gjithë besoj se jemi dakord që këto raste duhen të evitohen sa të jetë e mundur, sepse në çdo shoqëri ka problematike, por të gjithë duhet të bëjmë punën tonë.

Fjalën e ka zoti Gogu, në cilësinë e relatori.

Ju lutem, një përmbyllje pas diskutimeve!

**Toni Gogu** – E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Koha është gjyqtari më i rreptë midis virusit dhe vaksinës. Një sekondë të mbërrij virusi para vaksinës dhe ne shkojmë drejt fataliteteve, kështu që qeveria ka zgjedhur mjetin e duhur ligjor duke fituar kohë. Nuk mundet opozita të kërkojë ashklën në syrin e qeverisë, por duhet t'i inkurajojë dhe t'i nxisë 638 mijë qytetarët për t'u drejtuar menjëherë drejt qendrave të vaksinimit, sepse është e vetmja mundësi që ne kemi për të fituar betejën, e cila vazhdon ende tani që po flasim. Të vaksinuarit shumë rrallë hyjnë në qorrrokakët e jetës, të pavaksinuarit janë ata, sepse e kemi parë, ku jeta e tyre komplikohet, kështu që është vetëm akti normativ, sepse nuk ka mundësi tjetër, që ne të fitojmë kohë dhe të sigurojmë sa më shumë vakcina.

Prandaj ju ftoj të mos humbasim më kohë, ta miratojmë aktin normativ dhe të turremi në terren për të dhënë shembullin bazë për vaksinim si e vetmja mundësi! Nuk mundet të shkojmë përsëri në karantime dhe në kufizime të jetës sonë të përbashkët, prandaj vaksinohu, vaksinohu dhe vetëm vaksinohuni.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – U bashkohem plotësisht edhe sqarimeve të bëra nga ana e relatorit. Dua të shtoj diçka për të gjithë kolegët që ta dinë, pasi në bazë të ligjit për sëmundjet infektive me urdhrin e janarit të vitit 2020, jemi në gjendje epidemie, e nënshkruar nga ministrja e Shëndetësisë. Këto çështje, përveç argumentit dhe logjikës që paraqiti relatori, të cilat i ka edhe projektakti që po shqyrtojmë, shihen në përputhje me këtë urdhër.

Pra, nevoja dhe urgjenca janë tashmë të saktësuara në përputhje me Kushtetutën për sa kohë kemi një gjendje epidemie kombëtare me urdhër të ministres së Shëndetësisë në bazë të ligjit



për sëmundjet infektive, meqë shumica janë juristë duhet ta dinë, kjo e justifikon nevojën dhe urgjencën, përveç argumenteve, logjikës dhe nevojës për të vepruar sa më shpejt për t'i shpëtuar jetët më parë se virusi t'i marrë ato.

Duke ju falënderuar të gjithëve për këto diskutime, do ta hedh në votim, por ndërkohë të gjithë u shprehën që janë dakord. Gjej rastin të përgëzoj edhe opozitën që në këtë rast gjeti dakordësinë për të qenë pro këtij akti të rëndësishëm!

Për procedurë po e hedh në votim.

Kush është pro aktit normativ me Pfizer? 15 pro. Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Relatori dhe këshilltarët të bëjnë gati raportin për seancën plenare.

Faleminderit, zonja Komini dhe kolegë!

Shihemi në mbledhjen tjetër.

## **MBYLLET MBLEDHJA**